



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 391/112 Prot.

Tiranë, më 23.02 2026

V E N D I M

Nr. 28 dt. 23.02, 2026

**“PËR
MIRATIMIN E ANËTARËSIMIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
NË CROSSREF DHE PAJISJEN E REVISTAVE UNIVERSITARE ME DOI”**

Mbështetur në nenin 3, nenin 38 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të vecantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin nr.36, datë 24.1.2023 “Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 7, nenin 20 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, shkresën nr.257 prot., datë 02.02.2026 të Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë pranë Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit “Kërkesë për anëtarësimin e universitetit në Crossref dhe paisjen e revistave universitare me DOI (digital object identifier)”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.02.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e anëtarësimin të Universitetit të Sporteve të Tiranës në Crossref dhe pajisjen e revistave universitare me DOI (Digital Object Identifier).
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim njësisive kryesore të UST-së, Bordit të Administrimit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

